

C.nr:96/2016

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, gjyqtari Skender Shala, ne qeshtjen juridike kontestimore te paditesit nga Mirovica, kunder te paditures e cilen e perfaqeson Avokati kunder te paditures Komuna e Mitrovice – DKA, per pagimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellse me rastin e pensionimit, pas mbajtjes së seances së shqyrtimit kryesore, te dt. 20.03.2018, me dt. 30.03. 2018, bie kete:

AKT GJYKIM

APROVOHET E BAZUAR kerkesepadia e paditsit nga Mirovica, kunder te paditures dhe **DETYROHET** e paditura qe te ia paguaje paditsit ne emer te tri pagave përcjellse shumen prej 793.62, Euro si dhe ne emer te dy pagave per shperblim juoilar shumen prej 529.08 euro, e ne shume te pergjithshme prej 1.292,07 euro, (nje mije e dyqind e nentendhjet e dy euro e shtate cent), ne afat prej 7 (shtate) ditesh, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi, e nen kerënim te permbarimit.

Secila pale l barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyëti m

Paditsi ka ushtruar padi kunder te paditures per pagimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellse me rastin e shkuarjes ne pension.

Ne seancen e shqyrtimit kryesore te dt. 20.03.2018 paditesi ka deklaruar se mbes ne tersi pas padise dhe kerkese padise te parashtruar me propozim qe e njejtë te aprovohet ne tersi e bazuar. Une kam punuar prej dt. 1 Shtator te vitit 1990 deri me 26.01.2016, eka do te thote se kam punuar gjithsejtë prej 25 vite e 9 muaj dhe tere kete pervoj pune e kam bere ne SHMLM “ ne Mitrovice, andaj kerkoj nga gjykata qe ti mi aprovj 3 paga përcjellse ne sh lartesi te pages 264.54 dhe 2 paga jubilarë per shkak te shkuarjes ne pension. Ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi Mbes ne tersi prane deklarates se dhene ne seancen e sotme te shqyrtimit kryesor.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Perfaqesuesi I te paditures ne pergjigje nga padija dhe kerkesepadija deklaroi: e kundërshtoj padine dhe kerkesepadine mirepo te njejtën kohe nuk e kundërshtoj nxjerrejen e provave. Ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi se mbetem ne tersi prane deklarimeve ne seancen e sotme.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-se erdhe ne perfundim se duhet te vendosur si ne dispozitiv te keti Aktgjykimit.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: Vendimin e dt. 16.02.2017 leshuar nga DKA ne Mitrovice, Vertetimin nr. e dt. 29.12.2015, leshuar nga DKA ne Mitrovice, vendimin e dt. 18.06.2015 leshuar nga DKA ne Mitrovice, kerkesen , njoftimin nr. dt. 04.02.2016, kontraten e dt. 02.11.2015, qarkulimin per llogari ne TEB Banka e dt. 16.03.2018.

Pas analizimit dhe cmuarjes se provave te cekura nje nga nje dhe te gjitha se bashku si dhe rezultateve te tere procedures , gjykata e vleresoi se ne mes te paleve procedurale nuk jane kontestuese keto fakte:

Nuk eshte kontestu fakti se paditesi ka qene ne marredhenie pune te e paditura dhe ka punuar si puntor tekni ne SHMLM ne Mitrovice pa nderprere qe nga viti 1990 e gjer ne vitin 2016, gjithsejt 25 vjet e 9 muaj,

Nuk eshte kontestues fakti se paditesit marredhenia e punes i eshte pushuar me arritjen e moshes se pleqerise 65 vjecare, pasi qe me Vendimin e dt. 29.12.2015 leshuar nga DKA ne Mitrovice.

Nuk eshte kontestues fakti se lartesia e pages mujore neto e qe paditesi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit ka qene ne lartesi se prej 264,54 €.

Paditesi kerkesen e vet e mbeshtet ne Marveshjen e pergjithshme kolektive te Kosoves e konkretisht ne nenet 36 p.9.3 dhe 10 te Kontrates kolektive te arsimit parauniversitar te Kosoves.

Gjykata konsideron se ne rastin konkret kerkespadia e paditeses ne lidhje me pagat percjellese dhe atyre jubilar per shkak te shkuarjes ne pension eshte ne tersi e **BAZUAR** per keto arsye:

Gjykata per vendosje sipas pikes I te dispozitivit sa I perket pageses se dyi pagave ne emer te shperblimit jubilar iu referua nenit 36 par.9 nenpar. 9.3 dhe 9.4 te Kontrates Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosoves e dt. 11.04.2014 me te cilen parashihet se punemarresi I cili per 20 vjet radhazi dhe panderprere te pervojës se punes te punedhenesi I fundit ti njihet e drejta ne shperblim jubilar ne vlere-lartesia te dy pagave mujore te tij ndersa gjykata me rastin e vendosjes ne emer te kompenzimit per pagesen e tri pagave percjellese per pension u bazua ne paragrafin 10 te nenit 36 te Kontrates Kolektive te Arsimit Para universitar.

Bazuar ne nenin 36 par.9.4 te Kontrates Kolektive te Arsimit Para univesitar te Kosoves eshte detyrim i punedhenesit te fundit ketu te paditures qe ti paguaj kompenzimin per dy kategori te lartecekura.

Nga shkresat e lendes konstatohet se edhe perkunder kerkeses qe paditesja I ka parashtruar te paditures per pagesen ketyre kompensimeve e njejta nuk ka vepruar sipas obligimit nga neni 36 par. 9 nenpar.9.5 I Kontrates Kolektive te Arsimit Para univesitar te Kosoves te dates gjegjesisht ne afat prej nje muaji nga data e parashtrimit te kerkeses nga ana e paditesit nuk I ka bere kompensimin e e ketyre pagave me arsyen se ne Ligjin e Punes nuk jane parapa kompensimet te tilla.

Gjykata vendosi si ne piken I. te dispozitivit sa I perket pageses se dy pagave ne emer te shperblimit jubilar, duke u bazuar – referuar pervec Kontrates Kolektive te Arsimit Para univesitar te Kosoves edhe ne nenin 52 par. 1 nenpar.1.3 te Marreveshjes se pergjithshme kolektive te dates 18.03.2014; me te cilen parashihet se punemarresi I cili per 20 vite radhazi dhe panderprere te pervojës se punes te punedhenesi I fundit ti njihet e drejta ne shperblim jubilar ne vlere-lartesi te tri pagave mujore te tij andersa gjykata me rastin e vendosjes ne emer te kompensimit per pagesen e tri pagave percjellese per pension u bazuar ne nenin 53 te Marreveshjes kolektive te cilen parashihet e drejta e punemarresit paditesies me pagesen e percjellese te tri pagave mujore qe I ka marre ne tre muajt e fundit.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe pretendimet-kundershtimet e te paditures e cila pretendon se nuk eshte relevante dhe e fuqizuar per arsye se nuk eshte e nenshkruar nga te gjitha faktoret kompetent per lidhje te kontrates kolektive dhe per fuqizim te se njejtës , mirepo Gjykata keto pretendime nuk mundi ti merr si relevante dhe me adikim per vendosje ndryshe ne kete qeshtje lendore per arsye se nenshkruesi I kesaj kontrate eshte edhe ministria e Arsimit Shkenes dhe Teknologjise, keshtu qe bazuar ne arsyet e lartecekura vendosi si ne dispozitiv te ketj aktgjykimi.

Vendimin qe secila pale ti harte shpenzimet e veta te procedures kontestimore, bazohet ne baze te 459.1 te LPK-se.

Nga permbledhja e fakteve dhe arsyet ligjore te cekura me larte e ne kuptim te nenit 143 te LPK-se u vendos si ne dispozitiv te ketj aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.96/16, me dt.30.03.2018.

GJYQTARI,
Skender Shala



KESHILLE JURIDIKE :Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 7 ditesh, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.